

## **SHËNIM ORIENTUES NË LIDHJE ME PROCESIN E KONSULTIMIT**

---

Dokumenti mbi opsionet e niveleve kufi/pragjeve për klasifikimin e gjeneruesve të rinj që lidhen me sistemin, në tip A, B, C dhe D, sipas vendimit të ERE nr. 129, dt. 04/06/2018, “Mbi miratimin e Kodit të Rrjetit mbi Kërkesat për Lidhjen me Rrjetin të Gjeneruesve”, neni 5, përbën një draft për konsultim mbi të cilin mund të bëhen ende ndryshime të suportuara dhe argumentuara në mënyrën e duhur. Për këtë qellim, OST sh.a. mirëpret komentet dhe sugjerimet tuaja në lidhje me sa përshkruhet në dokument brenda një afati 30 ditor nga data e publikimit të dokumentit për konsultim në website e OST sh.a..

Përgjigjet tuaja mund të dërgohen me postë në adresën e OST sh.a. ose me email në adresën: [e.sala@ost.al](mailto:e.sala@ost.al)

Me qellim orientimin e duhur të konsultimit, komentet dhe sugjerimet do të merren në konsideratë nëse paraqiten në lidhje me temat si vijon më poshtë:

1. Cili nga opsionet e niveleve kufi të paraqitura në këtë dokument konsideroni se janë më të përshtatshme për t'u aplikuar për një periudhë prej të paktë 3 vjet duke filluar nga viti 2021 ?
2. Në lidhje me opsionin që konsideroni me të përshtatshëm mund të jepni një justifikim mbështetës, veçanërisht duke u përqendruar në përcaktimin e kostove / përfitimeve kur krahasohet me opsionet e tjera të paraqitura në këtë dokument.
3. Si mendoni se niveli kufi/pragu përmbush objektivat e Kodit të Rrjetit / Kodit të Shpërndarjes ?
4. A mbron në mënyrë adekuate niveli kufi/pragu që konsideroni më të përshtatshëm interesat e të gjithë Sistemit të Transmetimit, Përdoruesve dhe Sistemit të Shpërndarjes ? Nëse jo, pse nuk e bën këtë ?
5. A vendosin nivelet kufi/pragjet e propozuara një ekuilibër të përshtatshëm midis nevojave të Operatorit të Sistemit të Transmetimit, Shpërndarjes, Gjeneruesve dhe palëve të tjera të interesuara ? Nëse jo, pse ?
6. A ka konsiderata shtesë për nivelet kufi/pragjet që vëreni se nuk janë marrë parasysh në dokument ?
7. Ju lutemi jepni ndonjë koment tjetër që mendoni se është i rëndësishëm për çështjen në konsultim.